

Rubrika "Politikat e privatësisë" synon respektimin e kornizës kushtetuese e ligjore si dhe sensibilizimin e publikut dhe informimin e subjekteve mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzohen në këtë fushë.

Me hyrjen tuaj në këtë faqe interneti, ju pranoni se keni lexuar dhe pranuar kushtet si më poshtë vijon:

Kjo faqe në internet, në të cilën ju keni hyrë, <http://www.urdhrimjeve.org.al> është faqja zyrtare në internet e Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë, UMSH.

Urdhëri i Mjekëve të Shqipërisë është Ent Publik, i pavarur, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të anëtarëve të tij dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.

Misioni i Urdhërit të Mjekëve konsiston në nxitjen, bashkëpunimin dhe mbështetjen për arritjen e standardeve të larta të edukimit dhe formimit të vazhdueshëm mjekësor, të etikës dhe sjelljes profesionale, si dhe mbrojtjen e të sëmurëve dhe publikut nga kequshtrimi i mjekësisë.

Urdhëri i Mjekëve të Shqipërisë, funksionon në bazë të ligjit Nr. 8615, datë 1. 6. 2000 "Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë" dhe gjatë aktivitetit që ushtron dhe shërbimeve që ofron, mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale të subjekteve të të dhënave personale.

UMSH përpunon informacionin me qëllim kryerjen e detyrave të tij statutore dhe ligjore. UMSH siguron subjektet e të dhënave personale se të dhënat e tyre mbledhen dhe përpunohen vetëm për qëllime të realizimit të veprimtarisë ligjore dhe funksionale të UMSH duke marrë të gjitha masat fizike, teknike dhe operacionale për ruajtjen e konfidencialitetit si dhe mbrojtjen nga humbja, shkatërrimi, dëmtimi apo edhe shpërndarja e paautorizuar, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

UMSH ka detyrim ligjor të informojë publikun e gjerë periodikisht duke publikuar në *ëbsite* informacione të ndryshme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij, legjislacionin dhe vendimet e marra në zbatim të ligjit, informacione sensibilizuese etj. UMSH nuk bën asnjë përpjekje për të gjetur identitetin e vizitorëve që kanë vizituar faqen tonë të internetit, si dhe nuk lidh asnjë të dhënë të grumbulluar nga kjo faqe me ndonjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm nga çdo burim që të vijë, si pjesë e përdorimit tonë.

Subjektet e të dhënave personale kanë të drejtë të kërkojnë akses në të dhënat e tyre si dhe të kërkojnë që këto të dhëna të korrigjohen apo të përditësohen në përputhje me kërkesat e nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Të gjitha pikat e mësipërme janë përpiluar në përputhje me Kushtetutën, Nr. 8615, datë 1. 6. 2000 "Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, opinionin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat", si dhe akteve nënligjore në plotësim.

Burimi i informacionit për ligje, udhëzime e opinione: <http://www.kmdp.al>